

VENDIM
Nr. 531, datë 25.7.2019

**PËR SHPRONËSIMIN, PËR INTERES PUBLIK, TË PRONARËVE TË PASURIVE
TË PALUAJTSHME, PRONË PRIVATE, QË PREKEN NGA NDËRTIMI I
SEGMENTIT RRUGOR “STUDIM-PROJEKTIM, MASA INXHINIERIKE BUZUQ-
ÇOROVODË”**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të neneve 5, 20 e 21, të ligjit nr. 8561, datë 22.12.1999 “Për shpronësimet dhe marrjen në përdorim të përkohshëm të pasurisë, pronë private, për interes publik”, të ndryshuar, të ligjit nr. 9936, datë 26.6.2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, dhe të ligjit nr. 99/2018 “Për buxhetin e vitit 2019”, me propozimin e ministrit të Infrastrukturës dhe Energjisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Shpronësimin, për interes publik, të pronarëve të pasurive të paluajtshme, pronë private, që preken nga ndërtimi i segmentit rrugor “Studim-projektim, masa inxhinierike Buzuq-Çorovodë”.

2. Shpronësimi bëhet në favor të Autoriteti Rrugor Shqiptar (ARRSH).

3. Pronarët e pasurive të paluajtshme, që shpronësohen, të kompensohen në vlerë të plotë, sipas masës përkatëse që paraqitet në tabelën bashkëlidhur këtij vendimi, për pasuritë e llojit “truall”, “mur rrethues” dhe “kultura bujqësore”, me një vlerë të përgjithshme prej 1 422 145.31 (një milion e katërqind e njëzet e dy mijë e njëqind e dyzet e pesë pikë tridhjetë e një) lekësh.

4. Vlera e përgjithshme e shpronësimit, prej 1 422 145.31 (një milion e katërqind e njëzet e dy mijë e njëqind e dyzet e pesë pikë tridhjetë e një) lekësh, të përballohet nga buxheti i miratuar për vitin 2019, për Autoritetin Rrugor Shqiptar.

5. Shpenzimet procedurale, në vlerën 50 000 (pesëdhjetë mijë) lekë, të përballohen nga fondet e Autoritetit Rrugor Shqiptar.

6. Shpronësimi të fillojë menjëherë pas botimit të këtij vendimi në Fletoren Zyrtare dhe të përfundojë tre muaj pas datës së hyrjes në fuqi të tij.

7. Pronarët e pasqyruar në tabelën, që i bashkëlidhet këtij vendimi, të kompensohen, për efekt shpronësimi, pas heqjes së masës së sekuestros konservative dhe pasi të kenë paraqitur certifikatën e pronësisë, kartelën e pasurisë, si dhe hartën treguese të regjistrimit pranë Autoritetit Rrugor Shqiptar.

8. Afati i përfundimit të punimeve të jetë në përputhje me afatet e parashikuara nga ARRSH-ja.

9. Agjencia Shtetërore e Kadastrës, brenda 30 ditëve nga data e miratimit të këtij vendimi, në bashkëpunim me Autoritetin Rrugor Shqiptar, të fillojë procedurat për hedhjen e gjurmës së projektit në hartën kadastrale, sipas planimetrisë së shpronësimit të miratuar dhe të bëjnë kalimin e pronësisë, për pasuritë e shpronësuara në favor të shtetit, Autoritetit Rrugor Shqiptar.

10. Agjencia Shtetërore e Kadastrës, të pezullojë të gjitha transaksionet me pasuritë e shpronësuara, deri në momentin kur do të realizohet procesi i hedhjes së gjurmës së projektit mbi hartën kadastrale dhe kalimi i pronësisë në favor të shtetit, Autoritetit Rrugor Shqiptar, për pasuritë e shpronësuara.

11. Ngarkohen Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë, Agjencia Shtetërore e Kadastrës dhe Autoriteti Rrugor Shqiptar për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTËR
Edi Rama

LISTA E PRONARËVE QË SHPRONËSOHEN NË SEGMENTIN RRUGOR
“STUDIM-PROJEKTIM MASA INXHINERIKE NË AKSIN BUZUQ-ÇOROVODË”

Për ndërtimet vlerësimi është bërë sipas VKM-së nr. 138, datë 23.8.2000, i ndryshuar.
 Çmimi për pasurinë truall sipas vendimit nr. 89, datë 3.2.2016;
 Udhëzimit nr. 1, datë 5.10.2000, “Për kriteret teknike të përlogaritjes së vlerës së drufrutorve”.

Nr.	Emri	Atësia	Mbiemri	Zona Kadastrale	Numri i pasurisë	Sip. totale m ²	TOKË TRUALL		Vlera	OBJEKT Murë Rrethues	Vlera e kult. bujq. dhe dru frutorët (lekë)	VLERA TOTALE (lekë)	Shënime
							Sipërfaqja shpron. m ²	Çmimi (lekë/m ²)		Vlera sipas preventivit			
1	Bardhyl	Shefki	Aliçka	2739	196/1	6997	212	198	41976	699912.67	58000	799888.67	Sekuestro Konservative
2	Sokol	Muharrem	Bregu	2739	196/2	7083	246	198	48708	564548.64	9000	622256.64	Sekuestro Konservative
SHUMA TOTALE							458		90684	1264461.31	67000	1422145.31	

